



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ . 2025

PROCESVERBAL-Tipi i kontratës - Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është përefekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45210000-2, Punime ndërtimi.

VLERA E FONDIT LIMIT: 19,546,831 (nëntëmbëdhjetë milion e pesëqind e dyzetë e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH.

Argumentim:

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe V.K.M. Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit përcaktohet se në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim;

ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve, rezultoi vlera e përgjithshme e kontratës. Çmimet e përdorura në preventiv janë në përputhje me çmimet e "Sistemit të integruar të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim" i përcaktuar në pikën 2, të nenit 19, të VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim"

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 6 (gjashtë) muaj.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kritereve në Shtojcën 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit: $0,4 \times 19,546,831 = 7,818,732.4$ (shtatë million e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy .4)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perfshirjen e kriterit te cituar me lart, ne menyre qe t'i sherbeje autoritetit/entit kontraktor per njohjen e gjendjes financiare te operatorëve ekonomikë pjesemarres te mundshem si dhe te mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 date 28.12.1998 ”Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 dhe për vitin 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). *(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).*

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020 date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, neni 76 për kriteret detyruese për skualifikim, si dhe Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistemin e taksave vendore”, I ndryshuar.

2.2.3 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik ofertes duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore të 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të çertifikuar nga organet tatimore si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit).

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: “c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 49 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **9 577 947.19 (nëntë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e dyzetë e shtatë pikë nëntëmbëdhjetë) lek pa TVSH** dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht : **39 093 662 (tridhjetë e nëntë milion e nëntëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) lek pa TVSH.**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me
- Kontratë sipërmarrje;
- Situacion përfundimtar;
- Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
- Aktin e kolaudit;
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar.

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë sipërmarrje;
- Situacion përfundimtar;
- Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
- Akt kolaudimi objekti.

Në rastin e bashkimit të operatorëve pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët Ekonomikë, anëtar të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes

së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.

- Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 49 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatorit ekonomik ofertues i është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE – së, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Pra, dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që AK të përlogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1, shkronja a) dhe b).

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga *Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë* në bazë të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

NP – 3 A Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada

Për punimet speciale të ndërtimit

NS – 2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre

NS – 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.

NS – 14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësimin e licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008 ”Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8 402, datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ku neni 8 përcakton ”Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimi. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomikë të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko – profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP - 3	<i>(Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industrial, veshje fasadash)</i> Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punimet plotësuese dhe pajisje.	Të gjitha punimet e parashikuara në preventiv	A(0-20 milion) lekë	19 546 831.66

NS - 2	(Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirë). Konsiderohet montimi, mirëmbajtja ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.	Të gjithë zërat e punimeve që kanë të bëjnë me punimet e restaurimit e tualeteve	A (0 – 20 milion) lekë	310 924.60
NS - 4	(Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastic, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese). Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punime prej druri, të dymëve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastic dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me material të ndryshme.	Punime prishje shtresash, suvatime, bojatisje, dym-dritare etj	A (0 – 20 milion) lekë	18 342 235.36
NS - 14	(Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV). Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonik, radiotelefoni e TV, si dhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar në punimet e përgjithshme.	Të gjitha punimet që përfshihen në punimet elektrike të brendshme	A (0 – 20 milion) lekë	315 799.86

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (një) ing. Ndërtimi

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune
- Diplomë universitare
- Librezë pune
- CV

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Drejtuesin teknik të punimeve)

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar përsa i takon ndalimeve të dypunësimit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”*.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv.
- **2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:**

- **1 (një) Teknik Ndërtimi** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.

- **1 (një) manovratorë të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda** dhe për këtë duhet të paraqesin dëshmi nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, kontratë individuale pune. (në rastin kur punonjësit Manovrator janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.)

-1 (një) suvatues

Bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit me nr. analize 2.310/1, 2.331, 2.314/1 2.295, 2.312/1, 2.310, 2.300/1, 2.300 dhe sasisë së tyre, kërkohet që operatori ekonomik të disponojë 1 (një) bërës suvatues të cilët do të realizojnë këto punime.

-1 (një) murator

Bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit me nr. analize 2.88, 2.64/1 dhe sasisë së tyre kërkohet që operatori ekonomik të disponojë 1 (një) murator i cili do të realizojë këto punime.

-1 (një) bojaxhi

Bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit me nr. analize 2.404, 2.404/1, dhe sasisë së tyre kërkohet që operatori ekonomik të disponojë 1 (një) bojaxhinj të cilët do të realizojnë këto punime.

-1 (një) punonjës shtesash/ pllakashtrues

Bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit me nr. analize 2.200, 2.258/2 , 2.262/4, 2.267/a , dhe sasisë së tyre kërkohet që operatori ekonomik të disponojë 1 (një) punonjës shtesash /pllakashtrues të cilët do të realizojnë këto punime.

-1 (një) hidraulik

Bazuar në zërat për punimet në nyjet hidrosanitare dhe sasisë së tyre kërkohet që operatori ekonomik të disponojë 1 (një) hidraulik i cili do të realizojë këto punime.

-1 (një) elektrikist

Bazuar në zërat për elektrike dhe sasisë së tyre kërkohet që operatori ekonomik të disponojë 1 (një) hidraulik i cili do të realizojë këto punime.

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqiten:

- Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë ekzekutimit të kontratës
- Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik
- Diploma/çertifikata/ dëshmi të arsimit profesional
- Librezë pune

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mësipërm, emër/mbiemër, profili i punës, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri dhe titulli i kualifikimit për diplomën/certifikatën përkatëse, si dhe institucionin që ka lëshuar kete dokument.

-2 (dy) Shofer

Kur mjeti është në pronësi për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

- Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë ekzekutimit të kontratës.
- Dëshmi Aftësie Profesionale e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
- Leje drejtimi sipas kategorisë përkatëse
- Librezë pune

Kur mjeti bashkë me drejtuesin merren me qira për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

-Deklaratë nga operatori ekonomikë se në rast të shpalljes fitues do të paraqes kontratë pune me shoferat të cilët detyrimisht duhet të jetë i pajisur me Dëshmi Aftësie Profesionale të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Leje drejtimi (***Mos sjellja e kësaj kontrate apo dhe e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor pas shpalljes fitues të këtij operatori përbën kusht për s'kualifikimin e tij nga procedura dhe shpalljen si operator jo korrekt nga Autoriteti Kontraktor***)

Bazuar në të gjithë zërat e punimeve sipas preventivit, lëvizjen e materialeve të ndërtimit dhe punëtorëve kërkohet që operatori ekonomik të disponojë 2 (dy) shofera për drejtimin e mjeteve

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur për

çdo zë punimesh, bazuar në afatin përkatës të grafikut të punimeve. Kërkesa që punonjësit të kenë “Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme)” të lëshuara nga organizma të akredituara për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë është bërë duke u bazuar në ligjin Nr. 10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe VKM – në Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores Për sigurinë në kantier” Në kriterin mësipërcituar është kërkuar që OE të kenë të punësuar **punonjës të specializuar/të kualifikuar** për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, sipas fushave që përfshijnë punimet për zbatimin e projektit.

Këtu përfshihen kërkesat për punonjësit, të cilët janë trajnuar/certifikuar për kryerjen e punimeve të caktuara të zbatimit, pasi kanë kryer me sukses kurse dhe trajnime profesionale për punimet respektive. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Punëtorët e ndërtimit dhe profesionet e lidhura me to ndërtojnë, mirëmbajnë dhe riparojnë ndërtesat dhe strukturat e tjera që nga themelet, muret dhe pjesët të tjera kryesore të ndërtesës dhe konstruksione të tjera, si jashtë ashtu edhe brenda duke përdorur teknika dhe materiale tradicionale apo moderne të ndërtimit. Ata kryejnë punime murature, suvatime, shtrim pllakash, lyerje me bojë etj. Nisur nga punimet e parashikuara të zbatimit, në kriteret e veçanta janë kërkuar punëtorët e kualifikuar si më sipër si dhe numri i kërkuar për çdo specialist është minimumi i mundshëm për kryerjen e këtyre punimeve. Kërkesa e paraqitjes së “Diploma/certifikata/dëshmi të arsimit profesional” të lëshuara nga institucionet të akredituara buron nga zbatimi i Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Tekniku i ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Manovratorët** janë të nevojshëm për manovrimin e mjeteve të rënda që do të përdoren gjatë zbatimit të punimeve. Bazuar në orët e punës që dalin nga zbërthimi zë më zë i preventivit dhe afatit të punimeve rezultojnë të nevojshëm 1 manovratorë.
- **Shoferët** janë të nevojshëm për manovrimin e mjeteve (kamionave) që do të përdoren gjatë zbatimit të punimeve. Bazuar në orët e punës që dalin nga zbërthimi zë më zë i preventivit, afatit të punimeve si dhe sasisë së materialeve që do të transportohen rezultojnë të nevojshëm 2 shoferë.
- **1 Suvatuesi, 1 murator, 1 bojaxhi, 1 punonjës shtesash/ pllakashtrues, 1 hidraulik, 1 elektrikist,** janë të nevojshëm për kryerjen e punimeve bazuar në orët e punës që dalin nga zbërthimi zë më zë i preventivit dhe afatit të punimeve.

Kategorizimi i profesionit të punonjësve është bërë bazuar në kodet e përcaktuara në VKM 514 datë 15.09.2017

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur për çdo zë punimesh, bazuar në afatin përkatës të grafikut të punimeve.

Vendosja e këtyre kriterëve për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është përlllogaritur si dhe mjeteve të kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

Kërkesa që punonjësit të jenë me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) të lëshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë është bërë bazuar duke vlerësuar se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme.

Kërkesa për dëshmitë e drejtuesve të mjeteve të rënda bazohet në Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”

2.3.5 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

- a) 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave").*

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas të cilit: „*Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....*“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e

ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë, gjithashtu të jap ndihmën e parë në rastin e shfaqes së emergjencave. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të reazlizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë një numër mesatar prej jo më pak se 21 (njëzetë e një) punonjës të siguruar për 3 (tre) mujorin e fundit (duke përfshirë edhe stafin teknik të sipërcituar). Për t'a vërtetuar këtë duhet të paraqesë :

- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore/ose Tatimore.
- Listpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar më sipër dhe të jenë të konfirmuara nga Dega Rajonale Tatimore ku është i regjistruar subjekti.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar si dhe referuar grafikut të punimeve të hartuar nga projektuesi, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Numri i punonjësve është vendosur bazuar në sasinë e çdo zëri punimesh punimesh në preventiv dhe në natyrën e objektit të kësaj kontrate, pasi nga zbërthimi i zërave të preventivit dhe afati i parashikuar i punimeve janë gjithsej 18 732.71 orë pune punëtori dhe 875.2 orë pune makineri, për të cilat nevojiten 19 (18+1) punonjës, ku përfshirë dhe stafin teknik nevojiten në total të paktën 21 (njëzetë e një) punonjës.

Objekti: Permiresim i kushteve te banesave ekzistuese per komunitete te varfra dhe te pafavorizuara

PREVENTIV

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ORET E PUNES PUNETORI	ORET E PUNES TOTAL PUNETO	ORET E PUNES MAKINE RI	ORET E PUNES TOTAL MAKINER

						RI		I
1.BANESA VIOLETA DASHI								
		A. Punime Banese						
1	2.430/2	Prishje çatie ekzistuese me tjegulla	m2	57.00	1.62	92.34		0.00
2	2.426/1 1	Prishje suvatim muri i brendshem	m2	50.00	0.93	46.50		0.00
3	2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	15.00		0.00		0.00
4	2.310/1	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me pompe, ll perzier M 25	m2	100.00	0.775	77.50	0.220	22.00
5	2.295	Tavan rrjete teli + suva	m2	55.41	4.70	260.42		0.00
6	2.399	Sherbetisje e bojatisje me gelqere	m2	100.00	0.16	16.00		0.00
7	2.219	Çati vendi e zakonshme me HD~8m,tjegulla marseljeze	m2	57.00	2.30	131.10	0.02	1.14
8	2.209/a	Ulluk shkarkimi vertikal me PVC Ø 120	ml	3.00	0.545	1.64		0.00
9	2.206/b	Kasete shkarkimi me llamarine bakri 1.0mm	copë	1.00	1.216	1.22		0.00
10	2.212/a	Ulluk shkarkimi horizontal me PVC 33cm	ml	10.00	0.79	7.90		0.00
11	2.495	F.V lavaman porcelani	copë	1.00	2.95	2.95		0.00
12	2.501	F.V WC allafrenga	copë	1.00	3.70	3.70		0.00
13	2.515	F.V pilete dysHEMEJE Ø 50	copë	1.00	1.70	1.70		0.00
14	2.516	F.V. Tuba plastmasi dhe rakorderi	ton	0.02	834.00	15.01		0.00
15	2.491/b	FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 16	ml	15.00	0.30	4.50		0.00
16	2.520	F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 110	ml	10.00	1.43	14.30		0.00
17	2.480/3	F.V. Tub plastmasi Ø 22-26mm	ml	44	0.43	18.92		0.00
18	2.485	F.V. Çelesa e priza 10 A me nulifikim	copë	4	1	4.00		0.00
19	2.486	F.V. Portollampa norm 10 A	copë	4	0.55	2.20		0.00
20	2.489	F.V. Siguresa ~ 25 A	copë	1	0.29	0.29		0.00

21	2.490/b	F.V. Kasete plastike KE me 6 modular (vende)	copë	1	1.5	1.50		0.00
22	2.490/1 b	F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A	copë	2	1.3	2.60		0.00
23	2.481/1	F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	ml	49	0.04	1.96		0.00
24	2.481/2	F.V. Percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2	ml	69.16	0.04	2.77		0.00
25	2.487/a	F.V kuti suport pllaket 2 mod	copë	7.00	0.25	1.75		0.00
26	2.466	F.V. Ndricues tavanor fluoreshente 1x40w	copë	2.00	1.20	2.40		0.00
27	2.468	F.V. Ndricues plafoniere brace 1x40W	copë	1.00	1.20	1.20		0.00
		SHUMA 1				716.35		23.14

2. BANESA Liro Mece

		A. Punime Banese						
1	2.426/9	Prishje suvatim i jashtem	m2	124.20	1.308	162.45		0.00
2	2.426/1 2	Prishje suvatim solete (h<4m)	m2	68.30	1.71	116.79		0.00
3	2.426/1 3	Prishje suvatim kolona/trare (h<4m)	m2	20.00	1.77	35.40		0.00
4	2.197	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama	m2	30.00	1.00	30.00	0.05	1.50
5	2.212/a	Ulluk shkarkimi horizontal me PVC 33cm	ml	7.00	0.79	5.53		0.00
6	2.264	Shtrese lluster cemento 1:2	m2	30.00	0.66	19.80	0.03	0.90
7	2.300/1	Suva solete ~ 4 m, me drejtues, me pompe	m2	30.80	1.425	43.89	0.17	5.24
8	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m	m2	124.20	2.18	270.76	0.10	12.42
9	2.314/1	Suva trare e kollona ~ 4m, me pompe, ll perzier M 25	m2	20.00	1.475	29.50	0.31	6.20
10	2.295	Tavan rrjete teli + suva	m2	37.50	4.70	176.25		0.00
11	2.328	Patinim muri allçi (stuko)	m2	80.00	0.76	60.80		0.00
12	2.404	Boje hidroplastike	m2	392.00	0.36	141.12		0.00
		SHUMA 2				1,092.29		26.26

3. BANESA Ramo Lace

		A. Punime Banese						
1	2.426/1 2	Prishje suvatim solete (h<4m)	m2	18.20	1.71	31.12		0.00
2	2.426/1 1	Prishje suvatim muri i brendshem	m2	213.00	0.93	198.09		0.00
3	2.300/1	Suva solete ~ 4 m, me drejtues, me pompe	m2	18.20	1.425	25.94	0.17	3.09
4	2.297/c	Tavan i varur plastik	m2	51.6	2.10	108.28		0.00
5	2.312/1	Suva brenda mur guri ~ 4m, me pompe, ll perzier M 25	m2	213.00	0.875	186.38	0.17	36.21
6	2.404	Boje hidroplastike	m2	231.20	0.36	83.23		0.00
7	2.375	Dritare d/alumini tek xham	m2	6.75	2.20	14.85		0.00
8	2.391	Heqje dyer ekzistuese	m2	8.40	1.20	10.08		0.00
9	2.383	F.V dyer druri	m2	8.40	2.00	16.80		0.00
10	2.275	Shtrese betoni C16/20 me zgare hekuri	m3	3.00	8.60	25.80	0.73	2.19
11	An	Prishje tavan I varur plastik	m2	51.6	1.26	64.97		0.00
		SHUMA 3				765.53		41.49

4. BANESA GJERAQINA DERVISHAJ

		A. Punime Banese						
1	2.426/1 1	Prishje suvatim muri i brendshem	m2	150.00	0.93	139.50		0.00
2	2.426/9	Prishje suvatim i jashtem	m2	112.00	1.308	146.50		0.00
3	2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	20.00		0.00		0.00
4	2.310/1	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me pompe, ll perzier M 25	m2	180.00	0.775	139.50	0.220	39.60
5	2.605	Suvatim me llaç-çimento	m2	112.00	1.55	173.60	0.17	19.04
6	2.404	Boje hidroplastike	m2	180.00	0.36	64.80		0.00
7	2.375/2 a	Dritare d/alumini dyfi xh.	m2	7.20	2.20	15.84		0.00
8	2.383	F.V dyer druri	m2	10.00	2.00	20.00		0.00
9	2.391	Heqje dyer ekzistuese	m2	10.00	1.20	12.00		0.00

10	2.392	Heqje dritare ekzistuese	m2	6.20	1.17	7.25		0.00
11	2.266/1	Shtrese me pllaka granili me boje, 30x30cm	m2	60.00	1.54	92.40	0.07	4.20
12	2.480/3	F.V. Tub plastmasi Ø 22-26mm	ml	36.00	0.43	15.48		0.00
13	2.485	F.V. Çelesa e priza 10 A me nulifikim	copë	4	1	4.00		0.00
14	2.486	F.V. Portollampa norm 10 A	copë	4	0.55	2.20		0.00
15	2.489	F.V. Siguresa ~ 25 A	copë	1	0.29	0.29		0.00
16	2.490/b	F.V. Kasete plastike KE me 6 modular (vende)	copë	1	1.5	1.50		0.00
17	2.490/1 b	F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A	copë	3	1.3	3.90		0.00
18	2.481/1	F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	ml	42	0.04	1.68		0.00
19	2.481/2	F.V. Percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2	ml	58	0.04	2.32		0.00
20	2.487/a	F.V kuti suport pllaket 2 mod	copë	8.00	0.25	2.00		0.00
21	2.466	F.V. Ndricues tavanor fluoreshente 1x40w	copë	3.00	1.20	3.60		0.00
22	2.468	F.V. Ndricues plafoniere brace 1x40W	copë	2.00	1.20	2.40		0.00
23	2.496	F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m	copë	1.00	0.30	0.30		0.00
24	2.500	F.V. Percjelles Tokezimi , Cu, S=35mm2, i zhveshur	ml	8.51	0.05	0.43		0.00
25	2.481/3	F.V. Percjelles PV-500 Ø 4 mm2	ml	30.51	0.04	1.22		0.00
		SHUMA 4				852.71		62.84

5. BANESA NOVRUS KASAJ

		A. Punime Banese						
1	2.426/1 1	Prishje suvatim muri i brendshem >	m2	117.00	0.93	108.81		0.00
3	2.312/1	Suva brenda mur guri ~ 4m, me pompe, ll perzier M 25 >	m2	117.00	0.875	102.38	0.17	19.89
4	2.297/c	Tavan i varur plastik >	m2	43.93	2.10	92.25		0.00
5	2.219	Çati vendi e zakonshme me HD~8m,tjegulla marseljeze >	m2	97.00	2.300	223.100	0.020	1.94
6	2.267/a	Shtrese me pllaka grez porcelanato >	m2	64.00	1.66	106.24	0.07	4.48

7	2.262/1	Shtrese betoni C 7/10 >	m3	3.20	8.60	27.52	0.73	2.34
8	2.375/2 a	Dritare d/alumini dyfi xh. >	m2	5.50	2.20	12.10		0.00
9	2.395/a	Dyer d/alumini me mbushje element d/a. >	m2	4.60	2.40	11.04		0.00
10	2.388/1	F.V. Dyer te brendeshme tamburate te rimesuara >	m2	3.80	2.00	7.60		0.00
		SHUMA 5				691.04		28.65
6. BANESA ASTRIT DURAJ								
